

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Inteligjenca artificiale futet në prokurimet publike, Ibrahimaj jep afatin: Brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm! Teknologjia, rruga për të luftuar korrupsionin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/inteligjenca-artificiale-futet-ne-prokurimet-publike-ibrahimaj-jep-afat-1584961
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 12:54:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 14:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c4ff7260139efcc7c13092602157709696a9f2ed04113ba1d3601e650f573b00
TEKSTI	ea4f18427edd9cfe20e42700c0324b849e752776b626bf86aa1cfb9bea979b65
PAMJA	e47c9b22270b8fc34552002f64219ed62ee0623f01f42d1fedf7f8f252323db1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7a09289d1e9dce12d51233b3873ff82f01796fe444b2ed8dbbb19b86df8f486b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7a09289d1e9dce12d51233b3873ff82f01796fe444b2ed8dbbb19b86df8f486b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit ne Itali, ja kush eshte 35-vjecari qe u gjet ne bagazhin e nje makine me duar te lidhura! Ligj per “Made in Albania”? - Musabelliu: Dratit gati mekanizma per nxitjen fundit

Inteligjenca artificiale futet në prokurimet publike, Ibrahimaj jep afatin: Brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm! Teknologjia, rruga për të luftuar korrupsionin

9 Shtator 2026, 16:00Ekonomia TEMA



Inteligjenca artificiale futet në prokurimet publike, Ibrahimaj jep afatin:

Inteligjenca artificiale pritet të përfshihet në proceset e prokurimit publik në Shqipëri brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm. Afati u bë i ditur nga ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, gjatë ceremonisë së nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe Zyrës së UNOPS për Shqipërinë dhe Kosovën.

Ibrahimaj e vendosi theksin te përdorimi i teknologjisë dhe digjitalizimit në prokurimet publike, duke e lidhur investimin në teknologji edhe me rritjen e transparencës dhe luftën ndaj korrupsionit.

“Unë besoj fort që teknologjia dhe investimi në teknologji është e vetmja rrugë për të luftuar qoftë paragjykimin, qoftë eventualisht korrupsionin”, tha Ibrahimaj.

Sipas ministres, përfshirja e inteligjencës artificiale synon të përmirësojë dhe automatizojë proceset e prokurimit, të ulë kostot dhe të rrisë cilësinë e shërbimeve publike. Objektivi, sipas saj, është që inteligjenca artificiale të përfshihet në këto procese brenda vjeshtës së vitit të ardhshëm.

Deklaratat u bënë gjatë nënshkrimit në Tiranë të marrëveshjes “Prokurojmë së bashku për Shqipërinë Evropiane” mes Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe Zyrës së UNOPS për Shqipërinë dhe Kosovën.

Marrëveshja u firmos nga administratori i OBP-së, Jonaid Myzyri, dhe drejtorja e Zyrës së UNOPS për Shqipërinë dhe Kosovën, Sabine Kania. Në ceremoni morën pjesë edhe Ibrahimaj dhe Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Ingrid Macdonald.

Marrëveshja parashikon që UNOPS të ofrojë për gjashtë muaj mbështetje teknike për OBP-në. Në fokus do të jetë forcimi i kapaciteteve të institucionit, përmirësimi i mekanizmave të brendshëm dhe përafrimi i praktikave të prokurimit me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi synon gjithashtu zhvillimin e blerjeve strategjike dhe përdorimin më të gjerë të teknologjisë dhe zgjidhjeve inovative në prokurimin publik.

Ibrahimaj vlerësoi progresin e bërë në vitet e fundit në këtë fushë, ndërsa tha se reformat duhet të vijojnë për të rritur eficientë dhe transparencën. Ajo vlerësoi gjithashtu punën e stafit të OBP-së për ndërtimin dhe konsolidimin e institucionit.

Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Ingrid Macdonald, tha se prokurimi publik efikas ka rëndësi për forcimin e institucioneve dhe që fondet publike të përkthehen në shërbime cilësore për qytetarët.

“Përmes këtij partneriteti, UNOPS do të ofrojë ekspertizë ndërkombëtare për të mbështetur Operatorin e Blerjeve të Përqendruara në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e performancës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira”, tha Macdonald.

Drejtorja e Zyrës së UNOPS për Shqipërinë dhe Kosovën, Sabine Kania, tha se marrëveshja synon të krijojë bazat për procese prokurimi më transparente dhe efikase, duke ndërthurur ekspertizën ndërkombëtare të UNOPS me vizionin strategjik të OBP-së.

Administratori i OBP-së, Jonaid Myzyri, tha se mbështetja teknike do të shërbejë për integrimin e praktikave ndërkombëtare në sistemet e prokurimit dhe forcimin e standardeve të integritetit dhe llogaridhënies në menaxhimin e fondeve publike.

Projekti do të zbatohet gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, me fokus te stafi dhe mekanizmat e brendshëm të OBP-së.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ligj për “Made in Albania”? - Musabelliu: Drafti gati, mekanizma për nxitjen e eksporteve](#)

14:40 Ekonomia

[Guvernatori Sejko takohet me përfaqësuesit e Bankës Botërore: Shqipëria ecuri pozitive në rritjen dhe stabilitetin ekonomi](#)

13:30 Ekonomia

[Ish-qiramarrësit kredi pa interes - Ministrja Ibrahimaj: Aplikimi kryhet në e-Albania](#)

11:25 Ekonomia

[Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe europianët: 29% për ushqime, gati trefishi i BE-së](#)

08:35 Ekonomia / 2 komente

[Shqipëria pjesë e Kodit Global- Nga të dhënat te financimi, forcohet mbështetja për gratë sipërmarrëse](#)

15:20 Ekonomia / 1 koment

[Fatura e aksidenteve - AMF: Kompanitë e sigurimit paguan mesatarisht 175 mijë lekë për dëmet motorike](#)

16:10 Ekonomia / 2 komente

[Shqiptarët paguan 70 mln euro për të rivlerësuar pronat](#)

15:20 Ekonomia / 3 komente

[Kreditë nën monitorim: Historiku financiar i qytetarëve dhe bizneseve në një sistem të ri](#)

14:20 Ekonomia

[Transporti, sfida e tranzicionit - Plani i ri për dekarbonizimin: Elektrifikim, transport publik dhe hekurudhor](#)

13:50 Ekonomia / 2 komente

[Më në fund kontroll real i çmimeve?](#)

20:05 Ekonomia / 7 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 53 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 110 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...](#)

22:50 Kronika / 4 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 118 komente

Blog Tema

[Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...](#)

13:00 Blog / 1 koment

[Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat](#)

09:45 Blog / 3 komente

[25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001](#)

09:15 Blog / 5 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.